

**TË BËSH BIZNES 2016**  
**Ekstrakt me fakte: Evropa dhe Azia Qendrore**

**Cili është trendi i renditjeve?**

- Ekonomitë e Evropës dhe Azisë Qendrore kanë vlerësim mesatar sa i takon lehtësisë së të bërit biznes, në vendin 55, mesatarja e dytë më e lartë rajonale pas ekonomive me të ardhura të larta të OECD-së.
- Me renditjen më të lartë në rajon është vlerësuar **ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë**, në vendin 12 në renditjen globale. **Litania** vjen e dyta në rajon (në vendin 20), pasuar nga **Letonia** (22) dhe **Gjeorgjia** (24).
- Ekonomitë e mëdha të rajonit (dhe renditjet e tyre) janë **Kazakistani** (41), **Federata Ruse** (51), **Turqia** (55) dhe **Ukraina** (83).
- Mes ekonomive të rajonit, vetëm **Taxhikistani** ndodhet në një të tretën e fundit në renditje (në vendin 132).
- Mbrojtja e investitorëve të vegjël është fusha ku ekonomitë e rajonit kanë ecurinë më të mirë si mesatare (me renditje mesatare në vendin 46), pasuar ngushtë nga hapja e biznesit (47) dhe regjistrimi i pronave (49). Në rajon hapja e biznesit kërkon 10 ditë mesatarisht, sa një e dyta e mesatares globale që është 20 ditë. Dhe regjistrimi i pronave kërkon të njëjtën kohë mesatarisht në Evropë dhe Azinë Qendrore sa edhe në ekonomitë me të ardhura të larta të OECD-së.
- Rajoni ka më shumë vend për përmirësim në trajtimin e lejeve të ndërtimit (me renditje mesatare në vendin 98) dhe furnizimin me energji elektrike (94). Vendosja e një lidhjeje të re me energji elektrike në rajon kërkon 119 ditë mesatarisht, në krahasim me 78 ditë mesatarisht në ekonomitë me të ardhura të larta të OECD-së.

**Cili është trendi i reformave?**

- 22 prej 25 ekonomive në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore kanë zbatuar vitin që shkoi të paktën një reformë rregullatore që e lehtëson më shumë ushtrimin e aktivitetit të biznesit, 58 gjithsej. Ndërkohë që 92 për qind e ekonomive janë në reformim, Evropa dhe Azia Qendrore ka përqindjen më të lartë nga çdo rajon.
- Nga reformat e zbatuara në rajon, më së shumti ato janë në hapjen e biznesit (10), trajtimin e lejeve të ndërtimit (7), pagimin e tatim-taksave (7) dhe ekzekutimin e kontratave (7).
- **Qiproja, Uzbekistani dhe Kazakistani** kanë qenë ndër 10 vendet me më shumë përmirësim vitin që shkoi. Disa hollësi mbi reformat e këtyre vendeve:
  - **Qiproja** zbatoi 5 reforma. Mes të tjerash, e ka bërë zgjidhjen e paaftësisë paguese më të lehtë duke futur në përdorim procedurën e riorganizimit. Ka përmirësuar marrjen e informacionit për kredinë duke u dhënë mundësi zyrave të kredive të mbledhur dhe raportojnë informacione pozitive për kreditë dhe të raportojnë për historikun e kredive si për huamarrësit ashtu edhe për dorëzanësit.
  - **Uzbekistani** zbatoi 3 reforma. E ka bërë më të lehtë hapjen e një biznesi përmes futjes në përdorim të një shërbimi online me një ndalesë dhe thjeshtimit të procedurave të regjistrimit. Gjithashtu, ka përmirësuar mundësitë për marrje kredie përmes krijimit të një regjistri bashkëkohor dhe të unifikuar kolaterali, të mbështetur në njoftime.
  - **Kazakistan** zbatoi 7 reforma, numrin më të madh në nivel botëror. Mes ndryshimesh të tjera, e ka bërë më të lehtë hapjen e një biznesi përmes heqjes së kërkesës ligjore për përdorimin e vulës së shoqërisë. Gjithashtu e ka bërë më të lehtë ekzekutimin e kontratave përmes futjes së një procedure të thjeshtuar dhe të përsheptuar për paditë e vogla dhe përmes thjeshtimit të rregullave për procedurën e përmbarimit.

- **Federata Ruse** ishte një prej 5 ekonomive në gjithë botën që kanë zbatuar 5 ose më shumë reforma rregullatore vitin e fundit. Është bërë më e lehtë të hapësh një biznes në Moskë përmes uljes së numrit të ditëve të nevojshme për të hapur një llogari bankare biznesi. Gjithashtu e ka bërë më të lehtë, më të shpejtë dhe më pak të kushtueshme vendosjen e një lidhjeje me rrjetin e energjisë elektrike, përmes eliminimit të inspektimit të matësit nga ofruesit e energjisë elektrike dhe rishikimit të tarifave të lidhjes.

Ekonomitë	Renditja (1–189)		Distanca nga vlerësimet kufij (0–100)		Reformat	
	DB2015	DB2015	DB2015	DB2015	DB2015	DB2015
Shqipëria	62	97	66.77	60.50	3	2
Armenia	38	35	72.68	74.22	1	3
Azerbajxhani	63	63	66.65	67.80	3	3
Bjellorusia	43	44	71.79	72.33	1	2
Bosnja dhe Hercegovina	82	79	63.36	63.71	0	0
Bullgaria	36	38	73.62	73.72	1	0
Kroacia	39	40	72.50	72.71	3	1
Qipro	60	47	67.37	71.78	2	5
Gjeorgjia	24	24	76.84	77.45	0	2
Kazakistani	53	41	69.34	72.68	4	7
Kosova	64	66	66.11	66.22	2	1
Kirgistani	67	67	65.40	66.01	0	2
Latvia	22	22	77.51	78.06	1	3
Lituania	21	20	78.19	78.88	3	3
IRJ e Maqedonisë	14	12	79.69	80.18	3	2
Moldavia	49	52	70.76	70.97	2	2
Mali i Zi	47	46	71.05	71.85	1	2
Rumania	37	37	73.59	73.78	1	3
Federata Ruse	54	51	69.26	70.99	2	5
San Marino	78	76	63.64	64.21	1	1
Serbia	68	59	65.25	68.41	0	2
Taxhikistani	138	132	51.37	54.19	4	2
Turqia	51	55	69.93	69.16	1	1
Ukraina	87	83	62.31	63.04	1	1
Uzbekistani	103	87	58.81	62.60	2	3

*Shënim:* Renditjet mbështeten në distancën mesatare të çdo ekonomie nga vlerësimet kufij për 10 temat e përfshira në renditjet agregate të këtij viti. Kjo matje tregon sa larg apo afër ndodhet secila ekonomi nga praktikat më të mira globale në rregullimin e biznesit. Një vlerësim më i madh me pikë tregon një mjedis më efikas biznesi dhe institucione më të forta ligjore. Vlerësimet për “Të bësh biznes 2015” dhe “Të bësh biznes 2016” mbështeten në metodikën e re.

### **Shqipëria**

Këtë vit Shqipëria renditet e 97 në klasifikimin e përgjithshëm të lehtësisë të Të bërit biznes për 2016. Kjo renditje nuk është e krahasueshme me renditjen e raportit Të bësh biznes për 2015 për shkak të ndryshimeve metodologjike dhe rishikimit të të dhënave. Pas përshtatjes së të dhënave që janë bërë për Të bësh biznes për 2015 dhe matjeve të krahasueshme, renditja për vitin e kaluar do të kish qënë 62. Përsa i takon vlerësimin të distancës nga vlerësimet kufij, rezultati i Shqipërisë ka ndryshuar nga 66.77 vitin e kaluar në 60.50 për këtë vit, në bazë të metodologjisë krahasuese. Këto renditje janë të lidhura gjithashtu me një ritëm më të shpejtë reformash në vende të tjera. Renditja e Shqipërisë në Të bësh biznes 2016 është ndikuar edhe nga efekti afatshkurter i reformave në vazhdim si ajo territoriale, e cila përfshin një moratorium të përkohshëm për ndalimin e lejeve të ndërtimit.

**Ndryshimet metodologjike që prekën renditjen e Të bësh biznes 2016***Negative:*

- Furnizimi me energji: indikator i ri për vazhdimësinë e furnizimit dhe transparencën e tarifave shkaktoi një rënie prej 7 vendesh në renditjen e Shqipërisë në indikatorin e furnizimit me energji.

*Pozitive:*

- Në regjistrimin e pronës, zgjerimi i metodologjisë ishte përfitues për Shqipërinë duke e përmirësuar renditjen me 15 pozicione.
- Zbatimi i kontratave u përmirësua me 6 pozicione për shkak të ndryshimeve të metodologjisë.
- Në tregtinë ndërkufitare, Shqipëria përfitoi 58 pozicione krahasuar me renditjen sipas metodologjisë së vjetër.

**Reformat që kanë ndikuar renditjen në Të bësh biznes në 2016:**

Reformat e mëposhtme janë konsideruar nga Të bësh biznes si të tilla që kanë pasur ndikim në mjedisin rregullator të biznesit në Shqipëri:

*Negative:*

- Shqipëria e bëri më të vështirë marrjen e lejes së ndërtimit duke pezulluar lëshimin e lejeve të ndërtimit.

*Pozitive:*

- Shqipëria forcoi mbrojtjen e investitorëve të vegjël duke e kthyer në detyrim ligjor informimin e publikut mbi transaksionet me palët e treta.
- Shqipëria e lehtësoi eksportin përmes zbatimit të një sistemi elektronik inspektimi bazuar mbi riskun, e cila uli kohën e procedurave doganore.